



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



A.nr.2057/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi, dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Hava Fekaj, Zyrtare e Lartë për Inspektim Administrativ, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.2057/2025, të datës 22.12.2025, të parashtruar nga ankuesi F.K. nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Mbrojtjes, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 01.04.2026, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa më numër A.nr.2057/2025, të datës 22.12.2025, të parashtruar nga ankuesi F.K.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, F.K. (*tutje referuar vetëm si: ankuesi*), më datë 22.12.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Përgjigjes në kërkesë me numër protokolli 6196, të datës 16.12.2025, të u.d. Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 08.01.2026, dhe 04.02.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mbrojtjes, ndërsa, kjo e fundit, më datë 22.12.2025, dhe 05.02.2026 ka dorëzuar përgjigjen në ankesë, duke dhënë përgjigje në pretendimet ankimore të ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin në vijim Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 7998/2025 të datës 22.12.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë-ankesë e datës 05.12.2025 nga ankuesi për u.d. Drejtorin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së

Mbrojtjes; Përgjigjen në kërkesë e datës 16.12.2025 nga u.d. Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mbrojtjes për ankuesin; Akt Emërimit e datës 31.10.2025; Akt Emërimit e datës 11.06.2019; Listën e pagave për ankuesin tetor dhe nëntor 2025; Dëshmi nga lista e pagave për një nëpunës të kategorisë së ulët drejtuese; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 08.01.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 15.01.2025; Shkresë për kategorizimin e të gjitha kategorisë të personelit në Ministri të Mbrojtjes dhe në FSK e datës 06.10.2025; Listën e dërguar në DMZP nga Ministria e Mbrojtjes për kategorizim të pozitive të nivelit profesional dhe drejtues në muajin tetor 2025;Ndryshim dhe plotësim i Aktit të Emërimit i datës 11.06.2019;Përshkrimin e detyrave të punës; Diploma me nr.130/15 e datës 03 shtator 2015, ku ankuesi ka përfunduar studimet Themelore Universitare dhe mori gradën Bachelor në Menaxhment dhe Informatikë; Vendimin Nr.08/226 të datës 23.10.2024;Ligjin nr.08/L-198 për Pagat në Sektorin Publik; Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në rastin KO79/23;Rregullore (QRK) NR.07/2019, për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Mbrojtjes; Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës A.NR.1009/2024; Listat e pagave për ankuesin dhjetor 2022, janar-dhjetor 2023, janar-dhjetor 2024 dhe janar-dhjetor 2025;

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë si dhe pretendimeve ankimore të ankueses ka gjetur së ankesa e ankuesve **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se: Ankuesi fillimisht sipas Ndryshim dhe Plotësim të Akt Emërimit të datës 11.06.2019 është punësuar në pozitën Përkthyes, Sekretariati i Ministrisë së FSK-së në Ministrinë e Mbrojtjes sipas gradës A3, ndërsa tani sipas Akt Emërimit me Nr:5/95/2025 të datës 31.10.2025 mban pozitën e njëjtë të kategorisë së ulët drejtueses.

Ankuesi para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Agat në Sektorin Publikë, ka marr pagën sipas gradës A3, që rezulton se nga mars të vitit 2023 paga bruto ka qenë 1,78.30 Euron ndërsa, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Agat në Sektorin Publikë, ankuesi është kategorizuar në kategorinë profesionale, klasa profesional 1, dhe nga muaji shkurt 2023 deri në muajin nëntor 2025 është paguar koeficientit të klasës profesional 1 si dhe shtesën tranzitore.

Tutje, me ndryshimet sipas Akt Emërimit Nr:5/95/2025 të datës 31.10.2025, ankuesi është kategorizuar në kategorinë e ulët drejtuese me kasë dhe koeficient I9, grada A3, dhe nga muaji nëntor i vitit 2025 është paguar sipas pagës së kategorisë së ulët drejtuese pra koeficientit 8.4 dhe shtesës tranzitore e cila në pagën bruto ka qenë 1,078.30 Euro.

Ankuesi më datë 05.12.2025, me kërkesë i është drejtuar u.d. Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mbrojtjes, me të cilën ka kërkuar kompensimin për 26 muaj të pagës sipas kategorisë së ulët drejtuese meqë për plotë 26 muaj është paguar gabimisht në kategorisë profesionale klasa profesional 1.

Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, më datë 16.12.2025, përmes përgjigjes në kërkesë me numër protokolli 6190, i është përgjigjur ankuesit në kërkesën e tij, duke e njoftuar se pozita Shef i Zyrës së për përktim dhe lekturim pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, nga DMZP është kategorizuar në klasën profesional 1 dhe ky kategorizim është pasqyruar në listën e pagave, dhe meqë në mars të vitit 2025 kemi pasur procedurën e rekrutimit për pozitën Shef i Zyrës për Menaxhimin e Aseteve, të cilës i është njohur kategoria e ulët drejtuese, atëherë është ngritur çështja e rregullimit të kategorisë edhe për pozitën tij, dhe kjo ka ndodhur sipas akt emërimit të ri. Tutje ankuesi përmes përgjigjes në kërkesë është njoftuar se ndryshimi i pagës nga klasa profesional 1 në kategorinë e ulët drejtuese ndryshon në pagën bazë, zvogëlohet shtesa tranzitore mirë nuk ka asnjë ndryshim në pagën bruto bazë dhe neto, kështu që pretendimi se jeni paguar më ulët në raport me pagën që keni pasur është i paqëndrueshëm.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Përgjigjes në kërkesë me numër protokolli 6190, të datës 16.12.2025 të u.d. Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, pretendon se akti nuk trajton kërkesën lidhur me dëmin prej 26 muaj ku pozita është trajtuar gabimisht në listën e pagave pasi që kjo ka ndikuar në të drejta të tjera p.sh. bazën e pagës, përvojën e punës mbi pagën bazë, progresin, trajtim në sistematizim, të drejta nga pozita udhëheqëse etj. Tutje pretendon se ka diskriminim mes pagave për kategorisë e ulët drejtuese gjegjësisht pretendon se në rastin e tij paga është 950.94 euro ndërsa tek një rast tjetër 1,083.98 Euro. Kërkon që ankesa të aprovohet, të shfuqizohet akti i ankimues, të obligohet Ministria e Mbrojtjes të nxjerr akt të ri ku të përcaktoj dhe të zbatoj kategorizimin korrekt të pozitës sime për periudhën e kontestuar, të bëjë llogaritjen e të gjitha elementeve të pagës dhe të realizoj kompensimin retroaktiv për çdo difference që rezulton dhe të korrigjon evidencat në dosjen time dhe raportimet përkatëse.

Kolegj i Këshillit nga analizim i provave materiale të çështjes ka konstatuar se ankuesi, para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, paga e tij ka qenë sipas Gradës A3 apo në dhjetor të vitit 2022 paga bruto e tij ka qenë 1,049.22 Euro, suksese edhe në muajin janar të vitit 2023 ka qenë e njëjtë, ndërsa pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, (i zbatueshëm nga data 05.02.2023), bazuar në Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Kosovës lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve me qëllim të llogaritjes së pagës, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i Ministrisë së Punëve të Brendshme, pozitën e ankuesit e ka ekuivalentuar në kategorinë profesionale klasa profesional 1 sipas klasës dhe koeficientit I12-5.75, dhe nga muaji shkuar ankuesi sipas listës së pagave është paguar sipas koeficientit të klasës profesional 1 apo 5.75 duke ju llogaritur edhe shtesa tranzitore.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, përkatësisht nenin 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: *''1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji*

dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj'', dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, kurse klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit, konstaton se nëpunësit civil të Ministrisë së Mbrojtjes para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, kanë pasur pagë më të lartë në raport me nëpunësit e tjerë të institucioneve të tjera, ndërsa sipas këtij ligji gjegjësisht sipas shtojcës Nr. 10.6, pagat e nëpunësve civil janë përcaktuar njëllor për të gjitha institucionet e administratës shtetërore (ministritë), mirëpo në raport me nëpunësit civil që kanë pasur paga më të larta para hyrjes në fuqi të ligjit, është përcaktuar se në këtë rast aplikohet shtesa tranzitore, ndërsa Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, me Aktgjykimin për rastin Nr.KO79/23, ka shpallë të pavlefshëm paragrafin 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të këtij ligji, duke theksuar së e drejta në pagë të fituar është e drejtë e pronës dhe ka të gjitha atributet e kësaj të drejtë të garantuar më kushtetutë, rrjedhimisht si e drejtë e pa tjetërsueshme, duke sqaruar përmes pikës 383 të aktgjyimit se: *Ndërsa, në balancimin në mes të drejtave dhe lirive themelore dhe parimit të sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë, Gjykata, përmes këtij Aktgjykimi do të shpallë të pavlefshme dhe do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar. Shfuqizimi i paragrafëve që ndërlidhen me periudhën tranzitore, bazuar në paragrafin 1 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar, ka pasojën e (i) mbajtjes së nivelit ekzistues të pagave në sektorin publik, përkatësisht pamundësinë e zbritjes së pagave deri sa paga e re të 110 bëhet e barasvlershme me pagën aktuale; (ii) kthimin e pagës të paktën në nivelin para hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar për kategorinë e shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës dhe të cilët nuk kanë përfitur nga shtesa tranzitore prej njëqind për qind (100%) përgjatë vitit 2023, për dallim nga të gjitha kategoritë tjera; dhe (iii) nivelizimin e pagave të funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve që janë punësuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar sipas përcaktimeve të pikës 1.4 të nenit 4 (Parimet e sistemit të pagave) të Ligjit të kontestuar".* Kurse më pikën 385 të aktgjyimit, Gjykata Kushtuese kishte saktësuar se: *"385. Bazuar në pretendimet dhe argumentet e parashtruara para saj, Gjykata nuk ka trajtuar Shtojcat që janë pjesë përbërëse e nenit 44 të Ligjit të kontestuar. Përkundër faktit që (i) bazuar në vet Ligjin të kontestuar, ulja e pagës mund të bëhet vetëm si rezultat i një tronditje makroekonomike e cila rezulton në zvogëlimin e të ardhurave dhe/ose një fatkeqësie natyrore sipas kuptimit të nenit 131 të Kushtetutës, përkatësisht shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme në Republikën e Kosovës; dhe (ii) emëruesit të përbashkët të praktikës gjyqësore të Gjykatave tjera Kushtetuese, GJEDNJ-së dhe GJDBE-së, që ulja e pagës, në parim, mund të bëhet vetëm në rrethana të krizave ekonomike dhe/ose financiare, Gjykata ka vlerësuar qëllimin e Ligjit të kontestuar për të krijuar "një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik" si qëllim legjitim. Për pasojë, ajo nuk ka shpallur në kundërshtim me Kushtetutën nenin 44 të Ligjit të kontestuar përkitazi me Shtojcat në lidhje me paragrafin 1 të nenit 45 të Ligjit të kontestuar që përfshinë shfuqizimin e një numri të dispozitave të ligjeve të veçanta dhe të cilat rregullojnë pagën e një numri institucioneve në Republikën e Kosovës. **Sipas sqarimeve të dhëna në***

Aktgjykim, “një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik” arrihet përmes paragrafit 1 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar dhe sipas të cilit, nëse një zyrtar/e publik/e apo funksionar/e publik/e, para hyrjes në fuqi të këtij ligji përfitonte pagë që është më e madhe se paga e plotë e parashikuar me këtë ligj, ajo/ai do të përfitojë pagën e re sipas dispozitave të këtij ligji dhe shtesën tranzitore të barabartë me diferencën ndërmjet pagës aktuale dhe pagës së re bazë.

Në rastin konkret të ankuesit, edhe pse i njëjti është kategorizuar në klasën profesional 1, për muajin shkurt dhe mars të vitit 2023 karshi pagës sipas koeficienti 6.75 (klasës profesional 1) është aplikuar shtesa tranzitore në vlerën 442.85 Euro, prej muajit janar deri në muajin dhjetor të vitit 2023 për secilin muaj karshi pagës sipas koeficienti 6.75 është aplikuar shtesa tranzitore prej 442.85 Euro, prej muajit janar deri në muajin janar 2024, karshi pagës sipas koeficienti 6.75 është aplikuar shtesa tranzitore në vlerën 412.59 Euro për secilin muaj, prej muajit maj deri në muajin gusht të vitit 2024, karshi pagës sipas koeficienti 6.75 është aplikuar shtesa tranzitore në vlerën 409.43 Euro, karshi pagës sipas koeficienti 6.75 është aplikuar shtesa tranzitore në vlerën 406.27 Euro për secilin muaj, prej muajit maj deri në muajin dhjetor të vitit 2024, karshi pagës sipas koeficienti 6.75 është aplikuar shtesa tranzitore në vlerën 409.43 Euro, prej muajit janar deri në muajin maj të vitit 2025, karshi pagës sipas koeficienti 6.75 është aplikuar shtesa tranzitore në vlerën 347.83 Euro për secilin muaj, prej muajit qershor deri në gusht të vitit 2025, karshi pagës sipas koeficienti 6.75 është aplikuar shtesa tranzitore në vlerën 289.40 Euro për secilin muaj, karshi pagës sipas koeficienti 6.75 është aplikuar shtesa tranzitore në vlerën 285.68 Euro për secilin muaj, prej muajit gusht deri në shtator të vitit 2025, karshi pagës sipas koeficienti 6.75 është aplikuar shtesa tranzitore në vlerën 289.40 Euro për secilin muaj, karshi pagës sipas koeficienti 6.75 është aplikuar shtesa tranzitore në vlerën 285.68 Euro për secilin muaj, në muajin tetor të vitit 2025, karshi pagës sipas koeficienti 6.75 është aplikuar shtesa tranzitore në vlerën 91.93. Euro për secilin muaj, prej muajit nëntor deri në dhjetor të vitit 2025, karshi pagës sipas koeficienti 6.75 është aplikuar shtesa tranzitore në vlerën 289.40 Euro për secilin muaj nga çka rezulton se paga bruto e ankuesit nga muaji dhjetor 2022 që e ka pasur para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë deri në muajin tetor të vitit 2025 ka qenë për çdo muaj nga 1,078.30 Euro, pra e njëjtë. Kolegji i Këshillit, konstaton se duke rregullimi i kategorisë së pozitës së ankuesit sipas Akt Emërimit të datës 31.10.2025, është bërë në kuadër të kategorisë së ulët drejtuese, atëherë nga muaji nëntor 2025, ankuesi përmes listës së pagës është përfshirë në këtë kategori me koeficient të pagës 8.4 apo me pagë 944 Euro, dhe në këtë rast është aplikuar edhe shtesa tranzitore në vlerën 91.93 Euro për muajin nëntor dhe dhjetor të vitit 2025, ndërsa paga bruto për këta dy muaj ka qenë 1,078.30 Euro, pra e njëjtë me pagën që ka pasur.

Kolegji i Këshillit, konstaton se edhe pse ankuesi është kategorizuar sipas kategorisë profesionale 1, kjo nuk është bërë nga Ministria e Mbrojtjes, ngase nuk ka qenë kompetencë e saj, për faktin se kjo kompetencë ka qenë e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë dhe Thesarit të Kosovës sipas Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Kosovës, mirëpo edhe përkundër këtij kategorizimi, ankuesi nuk është dëmtuar në pagë, sepse i njëjti ka rezultuar të merr pagë të njëjtë sikurse ka marr para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, dhe në këtë aspekt nuk është vërejtur ndonjë raport diskriminues ndaj ankuesit, pra në rastin konkret edhe nëse ankuesi ishte paguar sipas koeficientit të kategorisë së ulët drejtuese nga muaji janar 2023 deri në muajin tetor 2025, paga bruto do të ishte e njëjtë, ngase në rastin konkret vetëm vlera e shtesës

tranzitore do të ishte më e vogël, por nuk do të kishte ndryshime rrënjësore në trajtimin e pagës definitive.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se ka diskriminim mes pagave për kategorisë e ulët drejtuese gjegjësisht pretendon se në rastin e tij paga është 950 euro ndërsa tek një rast tjetër 1,083.98 Euro, Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar në detaje këtë pretendim, dhe nga shkresat e lëndës të dërguar nga Ministria e Mbrojtjes, rezulton se sipas sistemit të gradave që ka Ministria e Mbrojtjes dhe që ka pasur para hyrjes në fuqi Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, konstatohet fakti se disa pozita të kategorisë së ulët drejtuese, janë paguar sipas Gradës A3, pra mbi bazë të pretendimit të ankuesit, kemi pranuar dëshmitë nga Ministria e Mbrojtjes përmes të cilave dëshmohet se nëpunësi F.K dhe, sipas listave të pagës në muajin janar 2023, janë paguar sipas Gradës A3 apo sipas pagës në vlerën bruto 1,078.30 Euro, rrjedhimisht Grada A3, për nga paga ka qenë më e lartë se Grada A3, ndërsa për ky nëpunësi civil përveç koeficientit të kategorisë së ulët drejtues është aplikuar shtesa tranzitore e cila është baravlerësuar me pagën që ka pasur para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, ndërkohë është aplikuar shtesa tranzitore që ka rezultuar e barasvlershme me pagën që ka pasur para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, andaj përkitazi me këtë Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi nuk mund të përdor analogji të njëjtë sepse ankuesi ka pasur gradën A3 sipas akt emërimit të datës 11.06.2019.

Ndërlidhur me pretendimin ankimor të ankuesit, se kjo ka ndikuar edhe në vlerësimin e përvojës së punës, Kolegji i Këshillit, referuar kompensimit lidhur më përvojën e punës, Kolegji i Këshillit iu referua nenit 6 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, me të cilin është përcaktuar se: *“6. Paga bazë rritet në bazë të përvojës së punës, në masën: 6.1. zero pikë njëzetë e pesë për qind (0.25%) për çdo vit të plotë pune, deri në pesëmbëdhjetë vite (15) punë; dhe 6.2. zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune, mbi pesëmbëdhjetë vite (15) punë”*, dispozita këto të cilat i janë nënshtruar vlerësimit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese, më ç’rast, kjo e fundit, me Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23, në pikën II të diapozitivit ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojta e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ndërsa, në pjesën arsyetues gjegjësisht në pikët 380 dhe 381 ka sqaruar: 380. *Gjykata ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) dhe paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit të kontestuar janë në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht me të drejtën në gëzimin paqësor të pronës dhe barazinë para ligjit. Kjo, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, ndër të tjera, sepse (i) zbritja joproporcionale e nivelit të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Kosovës është në kundërshtim të plotë me parimet kushtetuese, ligjore, parimet relevante ndërkombëtare dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe përtej cenimit të të drejtave respektive individuale, rezulton edhe në cenim të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe vlerave të Republikës së Kosovës;...ndërsa (v) përgjysmimi i shtesës për përvojën e punës për të gjithë kategorinë e funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve për pesëmbëdhjetë (15) vitet e para të përvojës së punës, kufizon të drejtat dhe liritë themelore të tyre, pa asnjë qëllim legjitim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 të Kushtetutës. 381. Thënë këtë, sipas sqarimeve të dhëna më sipër ndërlidhur dhe me efektin e Aktgjykimeve të Gjykatës, kjo e fundit (i) nuk do të shfuqizojë paragrafin 6 të nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit të kontestuar, ndërsa (ii) do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar.*

382 Kjo sepse, lidhur me paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar që ndërlidhet me shtesën mbi pagën për përvojën e punës, Ligji i kontestuar në paragrafin 1 të nenit 45 të tij, ka shfuqizuar edhe Ligjin nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, i cili përfshin nenin 18 (Shtesa mbi pagën për përvojën e punës) sipas të cilit, për çdo vit të përvojës së punës të kaluar në shërbimin civil dhe jashtë tij, përveç përvojës së kaluar në punë praktike, nëpunësit civil sipas këtij ligji i takon e drejta shtesë në pagën bazë prej zero pikë pesë përqind (0,5%). Shpallja e pavlefshme e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar i kombinuar me faktin që Ligji nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë shfuqizohet gjithashtu përmes paragrafit 1 të nenit 45 të Ligjit të kontestuar, do të rezultonte në zbrazëti ligjore, përkitazi më të drejtën për shtesa mbi pagën për përvojën e punës. Për pasojë, duke balancuar parimin e sigurisë juridike dhe të drejtat dhe liritë themelore, Gjykata do të lë **në fuqi paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në periudhën prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, duke i përcaktuar detyrimin Kuvendit, që brenda kësaj periudhe të ndryshojë dhe/ose plotësojë paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në pajtim me konstatimet e këtij Aktgjykimi.** Në ndryshimin dhe/ose plotësimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, Kuvendi duhet të ketë parasysh që efektet e ndryshimit/plotësimit të tij në kontekst të lartësisë së shtesës për përvojën e punës burojnë që nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi”, andaj, duke qenë se Kuvendi i Kosovës brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese nuk ka bërë plotësim/ndryshimin e nenit 6, paragrafi 6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Këshilli në mungesë të këtij rregullimi ligjor, nuk ka juridiksion që të detyroj institucionet publike të bëjnë kompensimin e përvojës së punës për zyrtarët publikë sipas sqarimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Po ashtu sipas shkresave të lëndës, gjegjësisht listës së pagave në dhjetor të vitit 2022, që është para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk rezulton se ndaj ankuesit është aplikuar ndonjë shtesë apo kompensim në kuadër të pagës bazë, e si rezultat i kësaj Kolegji i Këshillit, vë në dukje se ankuesi nuk është dëmtuar në këtë aspekt. Andaj Kolegji i Këshillit, vlerëson se ankuesi pretendimet e tij ankimore nuk ka mund të argumentoj me prova materiale, gjegjësisht nuk ka mund të argumentoj se është dëmtuar në aspektin materiale, e për rrjedhojë edhe pretendimet ankimore vlerësohen pa mbështetje ligjore.

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.2057/2025

Hava FEKAJ

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankuesit F.K;*
- *Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*